



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER MARIA M. DANO
ADRESA Nr.10, Kont Urani, Nr. 39
TEL: 694099966**

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 1258

Nr. koleksioni: 278

Tirane më 12/03/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

***Akti noterial përbëhet nga 3 fletë**



A2021053190031098595



KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI
(TË SHOQËRISË “SHPËRDHEJA” SH.P.K)

Sot, më datë 12/03/2021, para meje Notere MARIA M. DANO, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Nr.10, Kont Urani, Nr. 39, u paraqit personalisht:

SHITES:

Znj. Inesa Saliasi, atësia Niko, amësia Irma, shtetase Shqiptare, lindur në Lushnje, Lushnjë dhe banuese në LUSHNJE, me adresë Vasil Prifti 01710232; Nd. 62; H. 1; Ap. 15; Lushnjë; Lushnjë; 9001; Lushnje, lindur më 10/08/1997, gjendja civile “beqare”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 032704677 dhe nr. personal J75810132F.

BLERES:

Z. Mirel Shpërdheja, atësia Shkëlqim, amësia Luljeta, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në PATOS, me adresë Fitorja 01540046; Nd. 4; H. 1; Patos; Patos; 9307; Patos, lindur më 21/06/1997, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034276747 dhe nr. personal J70621092L.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë “SHPËRDHEJA” Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

NENI 1
OBJEKTI

1. Kjo kontratë ka për objekt shitblerjen e 1 kuote që përbën 50% (pesëdhjetë përqind), te vleres se kapitalit themeltar qe zoteron pala shitëse **Znj. Inesa Saliasi**, ne kapitalin e shoqerise “SHPËRDHEJA” SH.P.K, qe jane prone e pales shitese dhe te te gjitha te drejtave qe lidhen me to.
2. Pala blerese **Z. Mirel Shpërdheja**, i blen pales shitese 1 kuote që përbën 50% (pesëdhjetë përqind), te vleres nga kapitali themeltar qe zoteron pala shitëse **Znj. Inesa Saliasi**, ne Shoqerine “SHPËRDHEJA” SH.P.K.

NENI 2
ÇMIMI

1. Çmimi i shitjes se 1 kuote, që përbën 50 % (pesedhjetë per qind), te vleres nga kapitali themeltar qe zoteron pala shitëse ne shoqërinë “SHPËRDHEJA” Sh.p.k., eshte ne shumen e pergjithshme prej **50 000 (pesëdhjetë mije) Lekë**.
2. Likujdimi i çmimit të përcaktuar ne piken 1 te ketij neni, nga pala blerese tek pala shitese, eshte kryer jashte kesaj zyre noteriale dhe palet nuk kane asnje kundershtrim dhe mosmarreveshje per kete fakt ne kohen e redaktimit dhe nenshkrimit te kesaj kontrate.



NENI 3 DETYRIMET E PALEVE

Pala shitesë merr persiper dhe deklaron se është pronar i 1 (nje) kuote që përbën 50 % (pesëdhjetë për qind), nga vlera e kapitalit themeltar që zoteron pala shitëse në shoqërinë **“SHPËRDHEJA” Sh.P.K.**, me një çmim të përgjithshëm prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) Lekë, pagesë të cilën e ka marrë jashtë kësaj zyre noteriale sipas përcaktimit në nenin 2, pikë 2 të kësaj kontrate. Pala shitëse garanton palën blerëse, se kjo kuotë është e lire nga çdo barresim dhe detyrim karshi të tretëve dhe për çdo pretendim që mund të ngrenë të tretët për cenimin e të drejtës së pronësive së palës blerëse (eviksion), dhe është i gatshëm dhe i detyruar të paraqitet menjëherë me kërkesën e palës blerëse dhe të çdo personi tjetër të tretë, që pretendon mbi këtto kuota, para gjithë organeve gjyqësore dhe administrative për të mbrojtur të drejtën e tij, si pronar të ligjshëm i kësaj kuote pas nënshkrimit të kësaj kontrate. Pala blerëse deklaron se është njohur me situatën financiare të shoqërisë dhe nuk ka asnjë apo pretendim sipas dokumentit ligjor. Palet kontraktuese deklarohen se të gjitha detyrimet e përshkruara më lart dhe të gjitha ato që burojnë nga kjo kontratë shitje janë realizuar prej tyre dhe ata nuk kanë asnjë detyrim të ndërsjellë midis tyre. Palet kontraktuese deklarohen se kuota do të merret në dorëzim nga pala blerëse në gjendjen ekzistuese dhe ata nuk kanë asnjë pretendim në lidhje me këtë veprim.

NENI 4 PASOJAT TRANZITORE TË KALIMIT TË KUOTES

- a) Pala shitëse si dhe pala blerëse janë solidarish përgjegjëse ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotrimi i kuotës objekt të kësaj kontrate.
- b) Përgjegjësia solidare e palës shitëse dhe palës blerëse ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotave objekt të kësaj kontrate fillon nga çasti i kalimit të kuotave nepermjet nënshkrimit të kësaj kontrate dhe perfundon me regjistrimin e këtij kalimi në përputhje me dispozitat e ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 **“Për Qendren Kombëtare të Biznesit”** i ndryshuar.

NENI 5 EFEKTET E KONTRATES

1. Kalimi i pronësive së kuotës nga pala shitëse tek pala blerëse në përputhje me përcaktimet e kësaj kontrate perfundon me regjistrimin e kësaj kontrate pranë Qendres Kombëtare të Regjistrimit dhe në përputhje me përcaktimet e ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 **“Për Qendren Kombëtare të Biznesit”** i ndryshuar.
2. Kalimi i kuotave sipas kësaj kontrate regjistrohet në përputhje me dispozitat e ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 **“Për Qendren Kombëtare të Biznesit”** i ndryshuar.
3. Regjistrimi i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni ka efekt deklarativ.

NENI 6 DISPOZITA E FUNDIT

Kështu me firmosjen e kësaj kontrate nga palet kontraktuese dhe nënshkrimin e saj nga une noteria, pala shitëse zhvishet nga pronësia e 50 % (pesëdhjetë për qind), nga kapitali themeltar të shoqërisë dhe pronar i saj bëhet **Z. Mirel Shpërdheja**, duke gezuar të gjithë të drejtat ligjore mbi këtë kuotë në shoqërinë **“SHPËRDHEJA” Sh.P.K.** Pas kësaj shitjeje numri i kuotës të shoqërisë është një kuotë ku:

Z.Mirel Shpërdheja, bëhet ortak i vetëm i Shoqërisë **“SHPËRDHEJA” Sh.P.K.** Palet deklarohen se morren dijeni për kryerjen e regjistrimit të këtij akti noterial në QKB Tirane sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.



NENI 7 BAZA LIGJORE

Kjo kontratë hartohet edhe në baze dhe për zbatim të:

- a. Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe në veçanti nenit 659, nenit 690 dhe nenit 705 të tij;
- B. Statutin e shoqërisë “SHPËRDHEJA” SH.P.K;
- C. Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe në veçanti neni 73 dhe vijues të tij;
- D. Ligjit Nr. 110, datë 20/12/2018 “Për noterinë”;

E. Vendimit të Asamblesë së Ortakut të Shoqërisë “SHPËRDHEJA”-SH.P.K, me Nr.1, datë 12/03/2021.

NENI 8 DOKUMENTET E BASHKELIDHURA

Kësaj kontratë i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të jenë pjesë perberese e Kontratës;

- Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar për Shoqërinë “SHPËRDHEJA” Sh.p.k.
- Informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese, Tiranë;
- Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.
- Vendim i ortakeve të Shoqërisë “SHPËRDHEJA” Sh.p.k.

Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres. Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”, vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALET KONTRATUESE

PALA SHITESE

Z. Inesa Saliasi

PALA BLERESE

Z. Mirel Shpërdheja



NOTER
MARIA M. DANO



**VENDIM I ASAMBLESE
TE
ORTAKEVE TE SHOQERISE
"SHPËRDHEJA"- SH.P.K**

Nr. 1 , Date 12/03/2021

Ky vendim u mor sot, me date 12/03/2021, ne seline e shoqerise "SHPËRDHEJA"- Sh.P.K.

Shoqeria "SHPËRDHEJA"- Sh.P.K eshte person juridik shqiptar, i regjistruar ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit me nr. NIPT M11404029S, me nje kapital prej 100 000 (njëqind mije) Lekë.

Ortaket e shoqerise janë:

Znj. **Inesa Saliasi**, e cila zoteron 1 kuote qe perben 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise, njekohesisht dhe Administrator i shoqerise;

Z. **Mirel Shpërdheja**, i cili zoteron 1 kuote qe perben 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise,

Asambleja eshte mbledhur per te vendosur ne lidhje me pikat e rendit te dites:

- a. Miratimin e transferimit te 1 kuote qe perben 50 %, nga kapitali themeltar te shoqerise, te zoteruara nga ortaku i shoqerise "SHPËRDHEJA"- SH.P.K. nga Znj. Inesa Saliasi.
- b. Blerjen e 1 kuote qe perben 50 % nga kapitali themeltar te shoqerise "SHPËRDHEJA"- SH.P.K. nga Z. Mirel Shpërdheja.
Pas kesaj shitjeje numri i kuotave te shoqerise eshte nje kuote ku:
- c. Z. Mirel Shpërdheja behet ortak i shoqerise "SHPËRDHEJA"- SH.P.K. me 1 kuote qe perben 100 %, te vleres se kapitalit te shoqërisë SHPËRDHEJA"- SH.P.K
- d. Znj. Inesa Saliasi, te mbetet perseri në detyrën e Administratorit te shoqerise "SHPËRDHEJA"- SH.P.K.
- e. Te tjera eventuale.

Pasi shqyrtoi me kujdes pikat e rendit te dites, Asambleja e Ortakëve te Shoqerise, me vullnet te lire dhe te plote:

VENDOSI:

- Transferimin e 1 kuote qe perben 50 %, nga kapitali themeltar te shoqerise, te zoteruara nga ortaku i shoqerise "SHPËRDHEJA"- SH.P.K. nga Znj. Inesa Saliasi.
- Blerjen e 1 kuote qe perben 50 %, nga kapitali themeltar te shoqerise, te zoteruara nga ortaku i shoqerise "SHPËRDHEJA"- SH.P.K. nga Z. Mirel Shpërdheja.
- Z. Mirel Shpërdheja behet ortak i shoqerise "SHPËRDHEJA"- SH.P.K. me 1 kuote qe perben 100 %, te vleres se kapitalit te shoqërisë SHPËRDHEJA"- SH.P.K
- Znj. Inesa Saliasi, mbetet perseri në detyrën e Administratorit te shoqerise "SHPËRDHEJA"- SH.P.K.
- Depozitimimin e ketij vendimi nga ortaku i shoqerise Z. Mirel Shpërdheja dhe marreveshjes perkatese te transferimit te kuotes ne QKB Tirane.
- Shoqeria nuk ben ndryshime te tjera te cilat mbeten siç kane qene.

**ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE
"SHPËRDHEJA"- SH.P.K**

Inesa Saliasi

Mirel Shpërdheja

